



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 43
Prishtinë, më 5.4.2019, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Munguan: Glauk Konjufca, Fitore Pacolli dhe Dukagjin Gorani.

Pjesëmarrës nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Endrit Shala, ministër dhe Arbër Muhaxheri, drejtor në KIESA.

Pjesëmarrës nga Ministria e Punëve të Jashtme: Çerkin Dukolli, zëvendësministër dhe Jetish Jashari, drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate.

Pjesëmarrës të tjerë: Agonis Thaqi, Vjeshtore Zeqiri, D+; Yllka Gashi, praktikante, LDK; Ylli Sokoli, Doruntinë Pireva, Sofie Tahiri, praktikantë; Blerta Aliu, Ilir Hoxha, Aid Sekiraqa, KDI dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 25 shkurt, 6 dhe 7 mars 2019;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, z. Endrit Shala;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, z. Endrit Shala

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se investimet strategjike, për herë të parë, i mbulon ky komision në këtë mandat, përderisa organizatat ndërkombëtare janë tema që janë mbuluar edhe në të kaluarën. Ajo tha se janë zgjedhur, në veçanti, këto dy tema për raportim, edhe pse në komision ka raportuar drejtori i KIESA-s për zhvillimet në fushën e investimeve strategjike, mirëpo kanë kaluar përafërsisht 6 muaj dhe mund të ketë pasur zhvillime të reja, të cilat janë në interes të Kuvendit dhe të qytetarëve.

Endrit Shala, lidhur me investimet strategjike, njoftoi se statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për investime strategjike. Ministri njoftoi se nga muaji shkurt 2018 deri në muajin dhjetor 2018, MTI/KIESA ka pranuar 11 kërkesa për status të investitorit strategjik, dhe duke qenë se kërkesat ishin mjaft eksplicite, është vërejtur se nuk kishte harmonizim të mirë në mes ligjit dhe udhëzimit administrativ nr. 02/2018. Andaj, tha se ka lindur nevoja të hartohet një udhëzim i ri administrativ, me qëllim të eliminimit të burokracive, sa i përket fazave teknike të shqyrtimit të aplikimeve. Më tej, ai njoftoi se nga hyrja në fuqi e udhëzimit të ri administrativ nr. 15/2018, më 14.1.2019 deri më tani kanë aplikuar 12 subjekte të interesuara për të marrë statusin e investitorit strategjik. Shala paraqiti domosdoshmërinë e përgatitjes së projekteve strategjike nga ana e Qeverisë, në bazë të nenin 19.1 të Ligjit për investime strategjike, i cili përcakton se autoritetet publike mund të përgatisin projekte strategjike, të cilat mund t'i prezantohen subjekteve investuese dhe të kërkojnë prej tyre që të aplikojnë me projektet e tyre, sipas procedurave të përcaktuara me këtë ligj. Më tej, ai shtoi se procesi i zbatimit të Ligjit për investime strategjike është një proces kompleks dhe si i tillë kërkon shumë angazhim, gjë që për kapacitetet që i disponon KIESA, paraqet vështirësi në përmbushjen e obligimeve, në mënyre cilësore dhe brenda afateve të parapara.

Doruntinë Maloku- Kastrati, tha se ka dilema lidhur me mënyrën e funksionimit të çështjeve dhe investimeve strategjike, se si ndahen ato ndërmjet MTI-së, KIESA-s dhe Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Njoftoi se gjatë raportimit në komision, ministri i MDIS-së z. Gashi, si dhe ish-drejtori i KIESA-s, z. Mustafa, kanë folur për investimet strategjike, njëjtë sikur ministri Shala, prandaj është e pakuptueshme sesi po funksionojnë këto tri institucione për një çështje të njëjtë. Pyeti se si funksionon kjo ndarje.

Endrit Shala, duke iu referuar pyetjes së deputetes Maloku, tha se sponsoret dhe zbatues i Ligjit për investime strategjike është MTI, kurse KIESA është agjenci, e cila funksionon në kuadër të MTI-së. Po ashtu, theksoi se MDIS e ndihmon punën e MTI-së, me qëllim të zbatimit sa më të mirë të Ligjit për investime strategjike.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se në përgjegjësitë e MDIS-së nuk mund të shihet se kjo ministri e ndihmon ose asiston MTI, dhe kur raporton ministri i MDIS-së në komision, ai zakonisht raporton sikur të ishte ajo ministria kyçe, që e mbulon fushën e investimeve strategjike. Pyeti: A është ndërmarrë diçka nga MTI, që të eliminohen këto keqkuptime dhe cila është nevoja që MDIS-së t'i mbetet në portofol kjo çështje, pasi që puna në këtë fushë kryhet nga MTI?

Endrit Shala, tha se sponsoret dhe zbatues i Ligjit për investimet strategjike është MTI dhe KIESA, kurse ministri i MDIS-së dhe secili ministër i Qeverisë, kanë të drejtë të flasin për mundësinë e thithjes së investimeve në Kosovë dhe të ndihmojnë secilin dikaster të Qeverisë, me qëllim që Kosova të thithë sa më shumë investime.

Doruntinë Maloku- Kastrati, njoftoi se në takimet me bashkatdhetarët është parë nevoja që të ulet tavani për investime strategjike për pjesëtarët e diasporës, të cilët duan që nëpërmjet Ligjit për investime strategjike të investojnë në Kosovë. Lidhur me këtë, pyet: A ka bashkëpunuar MTI me MDIS, në këtë drejtim dhe si do të bashkërendohen punët, në mënyrë që edhe diaspora të përfshihet në Ligjin për investime strategjike?

Endrit Shala, tha se çështja e vlerës minimale për të fituar statusin e investitorit strategjik, është e përcaktuar me Ligjin për investime strategjike. Ai, më tej, njoftoi se MTI, deri më tani, nuk ka pranuar kërkesa për ndryshimin apo plotësimin e këtij ligji, gjegjësisht të vlerës minimale dhe nuk shohin ndonjë arsye për ta bërë këtë, pasi që mundësia për të thithur investime në Kosovë, sipas këtij ligji është deri në fund të vitit 2020.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ministri i MDIS, gjatë raportimeve në komision, ka treguar që së paku për projektet e diasporës duhet të merren parasysh kritere pak më të lehta, sa i përket investimeve strategjike dhe ministria e tij mund ta marrë përsipër ndryshimin e Ligjit për investime strategjike. Sipas saj, kjo tregon nevojën e një koordinimi më të mirë ndërmjet ministrive për këtë temë, sepse sikur të kishim një zbatim si duhet, do të mund të sillte investitorë të rëndësishëm në Kosovë.

Time Kadrijaj, në takimet që i ka pasur me pjesëtarët e diasporës, njoftoi se ka marrë shqetësimin e tyre, lidhur me tavanin për investimet strategjike. Pyeti ministrin: A ka raporte me rjetet e bizneseve që janë në diasporë? Po ashtu, shtoi se fakti që ka 2 vite që ka hyrë ligji në fuqi dhe janë vetëm 19 aplikime për ta fituar statusin e investitorit strategjik, janë pak. Ajo këshilloi ministrin që të ketë takime të rregullta me rjetet e bizneseve në diasporë, në mënyrë që të dihet saktë se çfarë kërkojnë, që numri i investitorëve në Kosovë të rritet.

Endrit Shala, tha se MDIS e ushtron përgjegjësinë e saj në kontakt me diasporën, duke tentuar të thithë investime të mundshme nga diaspora dhe njoftoi se në bashkëpunim me MDIS kanë organizuar sesione informuese për diasporën. Sa i përket ndryshimit të vlerave për kualifikim, si investitor strategjik në sektorë të caktuar, bëri të ditur se vlera 30 milionë është vetëm për sektorin e energjisë dhe infrastrukturë në miniera, kurse për sektorë tjerë, kjo vlerë ndryshon e në disa raste mund të jetë edhe më pak se 10 milionë euro investime.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, bëri të ditur se në mbledhjet e komisionit është diskutuar se ndoshta ka një konflikt të kompetencave në mes të dy ministrive, mirëpo kjo çështje është tejkaluar mirë deri më tani, përderisa ju punoni dhe nuk ka pengesa. Pyeti ministrin për punën e komisionit qeveritar, lidhur me investimet strategjike.

Endrit Shala, duke iu referuar pyetjes së deputetes Thaçi, bëri të ditur se Ligji për investime strategjike përcakton që procedurat për zbatimin e këtij ligji i bën Komisioni Ndërmintor për Investime Strategjike, të cilin e udhëheq ai si ministër i MTI-së, dhe i cili përbëhet nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Ambientit, ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, ministri i Bujqësisë dhe Pylltarisë, ministri i Zhvillimit Ekonomik, kryetari i komunës, ku bëhet investimi dhe avokati i përgjithshëm shtetëror. Më tej, sqaroi se Komisioni Ndërmintor është themeluar për vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve për investimet strategjike dhe rekomandimet e këtij komisioni i propozohen Qeverisë për miratim. Nëse një investim strategjik prek pronën publike, atëherë Qeveria i rekomandon Kuvendit një miratim të tillë apo jo.

Elmi Reçica, tha se ne iu inkurajojmë që të jeni sa më efektivë dhe të prodhoni rezultate, sa i përket investimeve strategjike në Kosovë, dhe konform kësaj, jemi të interesuar që diaspora jonë të investojë këtu. Po ashtu, z. Reçica, sa i përket investimeve strategjike, njoftoi se ka kërkesa për dokumente dhe po krijohen situata të ndryshme, që për shkak të ligjeve që i kemi, nganjëherë po shndërrohen në pengesa, me të cilat po lodhet një pjesë e investitorëve. Në këtë drejtim, tha se MTI e ka mbështetjen e komisionit dhe të Kuvendit, por veçanërisht të diasporës, që të bëhen lehtësira ose të thjeshtëzohen procedurat për t'u kualifikuar si investitor strategjik. Më tej, shtoi se nuk është kundër investimeve të kompanive të ndryshme, por duhet të trajtohen me prioritet njerëzit tanë në diasporë, dhe në këtë drejtim, MTI dhe MDIS duhet të krijojnë lehtësira, sa i përket investimeve nga ana e diasporës.

Doruntinë Maloku- Kastrati, duke iu referuar raportit të ministrit, dërguar komisionit në të cilin thuhet se në janar 2019 ka hyrë në fuqi një udhëzim i ri administrativ, i cili pas hyrjes në fuqi ka sjellë edhe 12 aplikacione të reja, pyeti: Çka përfshin ai udhëzim, çfarë ka të re në atë udhëzim, që ka bërë që të tërheqë investitorë të rinj?

Endrit Shala, njoftoi se diasporës i është ofruar një zonë ekonomike, me gjithë infrastrukturën e nevojshme që iu duhet bizneseve, dhe në bazë të Ligjit për zonat ekonomike, ata kanë përfitime dhe

lehtësira me rastin e marrjes së një parcele në zonën ekonomike. Ministri ftoi komisionin, për ta realizuar një vizitë në MTI, ku mund të shihet nga afër puna që është duke u bërë nga MTI dhe KIESA, në shqyrtimin dhe trajtimin e investitorëve potencialë strategjikë. Sa i përket pyetjes së deputetes Maloku, ministri bëri të ditur se ka qenë një udhëzim administrativ në fuqi, të cilin e ka konsideruar burokrat dhe i cili e ka penguar mundësinë e thithjes së investitorëve. Më tej, tha se udhëzimi i ri i ka paraparë disa lehtësira dhe kjo është vërtetuar si një mundësi më e mirë për thithjen e investitorëve strategjikë.

Doruntinë Maloku- Kastrati, propozoi që MTI ose KIESA të bëjë një fushatë sensibilizuese për ndryshimin e udhëzimit administrativ, në mënyrë që të sillen më shumë investime apo të sensibilizonte të tjerët, që t'i fillojnë investimet më shpejt.

Endrit Shala, tha se jemi duke u munduar që të bëjmë më të mirën me buxhetin që disponojnë dhe kërkoi nga deputetët që të përkrahen në kërkesat të cilat i kanë, po ashtu edhe në kërkesat buxhetore.

Zafir Berisha, tha se jemi në momente delikate për vendin, për investime strategjike, duke pasur parasysh se situata politike, veçanërisht ajo e sigurisë në Kosovë nuk është aq e arritshme për investitorët e huaj, me fushatën që është duke e bërë Serbia, në raport me situatën e sigurinë politike. Pyeti nëse ministria ka ndonjë plan apo strategji të lobimit për investime strategjike, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat gjendemi.

Vjosa Osmani- Sadriu, pyeti ministrin: Si ka ndikuar vendosja e taksës në procesin e investimeve? Po ashtu, potencoi se ka pasur zëra se vendosja e tarifës në raport me mallrat serbe mund ta paraqesë Kosovën si një vend jo të përshtatshëm për investitorët e huaj. Ajo, po ashtu, kërkoi që të informohen lidhur me projektin e Brezovicës dhe cila komunë ka kërkuar pezullimin e këtij projekti. Duke u ndërlidhur me investimet strategjike, pyeti: A është shqyrtuar mundësia e zgjatjes së afatit kohor, si dhe me rastin e hartimit të ligjit të ri, duke i pasur parasysh edhe modelet e shteteve të tjera, a ka ndonjë mënyrë që projektet, të cilat përfshijnë rininë, të kenë njëfarë përparësie? Lidhur me projektin në fushën e minierave, pyeti: A është pezulluar, a i është dhënë leja dhe a është kualifikuar si investim strategjik?

Endrit Shala, tha se ministria është duke u angazhuar për organizimin e aktiviteteve jashtë vendit, me qëllim të promovimit të mundësisë së investimeve në Kosovë. Vendimin për masën ndaj produkteve të Serbisë e Bosnjës, tha se e ka marrë Qeveria, me propozim të tij, ndërsa bëri të ditur se kjo masë nuk i pengon investitorët e huaj. Njoftoi se deri më tani ka të interesuar për të investuar në Brezovicë, ndërsa projekti i kaluar është pezulluar me kërkesë të Komunës së Pejës. Ministri, më tej, njoftoi se MTI parasheh që ky ligj të amendamentohet dhe kërkoi përkrahjen e deputetëve, që gjatë amendamentimit, të parashihen pengesat që i ka pasur ministria gjatë zbatimit të tij, e po ashtu që ligji i ardhshëm të mbizotërojë ndaj ligjeve të tjera, brenda Kushtetutës. Sa i përket sektorit të minierave, tha se kanë dy aplikacione që janë në fazën e shqyrtimit teknik.

Doruntinë Maloku- Kastrati, kërkoi të informohet nga ministri se çfarë ka ndodhur me kërkesën e Komunës së Podujevës për dhënien e një zone publike për shfrytëzim, të cilën e menaxhon AKP, për vendosjen e bizneseve dhe zhvillimin e veprimtarive të tyre në atë hapësirë.

Endrit Shala, njoftoi se si ministri kanë për synim që secilës komunë t'i krijohet zonë ekonomike, ashtu siç e parasheh ligji, sepse është mënyra më e mirë për thithje të investimeve. Ministri bëri të ditur se kanë një kërkesë nga Komuna e Podujevës, për një zonë ekonomike dhe Qeveria në bashkëpunim me AKP-në do të bashkëpunojnë, që ajo tokë të ndahet për zonë ekonomike në Komunën e Podujevës. Ministri, më pas, njoftoi se janë duke punuar që të krijohen zona ekonomike edhe në komunat tjera të Kosovës.

Elmi Reçica, sa i përket investimeve strategjike, propozoi që komisioni, së bashku me ministrinë, të realizojë vizita në Shqipëri, Mal të Zi e Maqedoni, për të parë përparësitë dhe lehtësirat e tyre në procesin e investimeve strategjike, në mënyrë që të gjejë zgjidhje për përshejtimin e procedurave dhe fillimin e investimeve sa më shpejt edhe te ne.

Vjosa Osmani- Sadriu, lidhur me nismën për procesin e anëtarësimit të Kosovës në OBT, pyeti ministrin: Pse është paraparë që Kosova të aplikojë për anëtare vëzhguese, e jo anëtare me të drejta të plota?

Endrit Shala, njoftoi se në qershor të vitit 2018, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për fillimin e procedurës për aplikim në OBT, si anëtare vëzhguese, dhe si rrjedhojë e këtij vendimi, i ka përgatitur dokumentet e nevojshme. Përfitimi i statusit vëzhgues për Kosovën, kërkon një platformë edhe të lobimit në shtete të ndryshme, me theks të veçantë, në shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Kosova ka vendosur të aplikojë për statusin vëzhgues, sepse është mënyra më e lehtë që të jetë brenda OBT-së dhe të përfitojë nga të qenit anëtar vëzhgues në OBT. Më tej, ai potencoi arsyet nga perspektiva politike dhe ekonomike që janë në interes që Kosova të marrë statusin e anëtarit vëzhgues.

Vjosa Osmani- Sadriu, kërkoi që dokumenti, pasqyra ekonomike e Kosovës, politikat ekonomike dhe regjimi i tregtisë së jashtme, i cili është dërguar për komente në institucionet relevante, të ndahet edhe me komisionin. Pyeti: A është planifikuar që aplikacioni për anëtarësim në OBT, të dorëzohet këtë vit? Ajo, po ashtu, pyeti ministrin se nga momenti i aplikimit deri te momenti i anëtarësimit në OBT, si anëtare vëzhguese, sa kohë mendon se mund t'i marrë Kosovës, duke pasur parasysh se ka shtete që kjo procedurë i ka marrë edhe deri në 20 vite.

Endrit Shala, njoftoi se ministria është në koordinim me MPJ-në, për ta gjetur momentin e duhur për të aplikuar. Lidhur me lobimin, ministri bëri të ditur se kanë filluar procedurën për anëtarësim në EFTA dhe të gjitha vendet anëtare të saj kanë premtuar se do ta ndihmojnë Kosovën me lobim për anëtarësim në OBT. Sa i përket dokumentit, pasqyra ekonomike e Kosovës, politikat ekonomike dhe regjimi i tregtisë së jashtme, ministri tha se do t'ia përcjellin komisionit. Po ashtu, ministri bëri të ditur se shumë shtete të rajonit kanë shumë vite që janë në proces të anëtarësimit në OBT, ndërsa sa i përket kohëzgjatjes së procesit të anëtarësimit të Kosovës në OBT, tha se nuk është konsultuar me ekspertë dhe ky proces kërkon një planifikim gjithë institucional.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe është kërkuar që ta arsyetojë ministri, por jemi informuar nga kabineti i tij, se ministri do të jetë jashtë vendit, ndërsa tani paraqitet drejtpërsëdrejti në një konferencë për shtyp nga MPJ.

Çerkin Dukolli, lidhur me projektligjin, theksoi se situata në fushën e politikës së jashtme ka evoluar edhe për shkak të shmangies nga keqkuptimet sipas ligjeve në fuqi, është vendosur që të nxjerrim një ligj më funksional. Risi, në këtë projektligj të propozuar, është parashikimi i drejtorit politik, drejtorive të përgjithshme, depolitizimi i ambasadave me 70% të diplomatëve të karrierës, marrja e gradave, risi në nenin 85, si dhe në nenin 20.8.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se projektligji, në përgjithësi, i jep diskrecion të madh ministrit, gjë që nuk ka ekzistuar më herët. Pyeti: pse është paraparë e nevojshme një gjë e tillë? Diplomatët e karrierës e kanë tanimë statusin e karrierës, ndërsa sipas nenit 85.1, siç po shihet, procesi është paraparë për të gjithë diplomatët, dhe nëse e lëmë nenin kështu siç është, atëherë neni 85 e ofron mundësinë që çdo diplomat që shërben, pavarësisht a e ka fituar këtë status sipas procedurave të karrierës apo emërimit

politik, nëse e kalojnë testin 100% nga ata, mund të fitojnë këtë status dhe lihet hapësirë që automatikisht të gjithë të bëhen diplomatë të karrierës.

Çerkin Dukolli, theksoi se katër paragrafët nga neni 85 kanë nevojë që të riformulohen në mënyrë që të hiqen dilemat.

Jetish Jashari, njoftoi se ka qenë pjesë e grupit punues ndërinstitucional dhe kjo dispozitë ka ngjallur debat më shumë se dispozitat tjera. Sipas tij, kjo dispozitë nuk ka të bëjë me përfshirjen e diplomatëve, të cilët nuk janë anëtarë të shërbimit të jashtëm, por ka të bëjë vetëm me anëtarët e shërbimit të jashtëm.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se duke pasur parasysh se në nenin 85 thuhet se të gjithë anëtarët e shërbimit të jashtëm, të cilët e kalojnë procesin e vlerësimit, e fitojnë statusin e diplomatit të karrierës dhe pyeti përfaqësuesit e ministrisë se a mendojnë se paraqitet kolezion në mes të dispozitës 85 dhe 1.10. Ajo theksoi se në nenin 61 nuk është hezitur të përdoret terminologjia, diplomat karriere dhe sistemimin e tyre, në rast se kthehen në ministri, sepse vetëm diplomatët e karrierës e kanë të drejtën sipas rotacionit të sistemohen në ministri, ndërsa nuk kemi kurrfarë obligimi ndaj të emëruarve politikë. Pyeti përfaqësuesit e ministrisë: A mund të shpjegojnë se pse është paraparë vlerësimi total i diplomatëve përmes testit?

Çerkin Dugolli, lidhur me vlerësimin e diplomatëve, tha se gjatë procedurës së hartimit nuk ka pasur konsensus. Në MPJ ekziston gatishmëria që të hiqet ky nen apo të riformulohet.

Vjosa Osmani- Sadriu, më tej, tha se në nenin 62 ka diskrepancë, ku thuhet se ministri, me vendim, urdhëron mbarimin e parakohshëm të mandatit të diplomateve të karrierës, pa e sqaruar se kjo nuk mund të bëhet për shefa të misioneve, sepse është kompetencë e Presidentit, e jo e ministrit. Në vazhdim, theksoi se në nenin 4 nuk janë marrë parasysh vërejtjet e Zyrës së Kryeministrit që e kanë kundërshtuar gjuhën “orienton drejtimin e saj”, sepse nuk parashihet kështu me Kushtetutë.

Çerkin Dugolli, njoftoi se drafti përfundimtar i projektligjit i është përcjellë Zyrës së Kryeministrit, të cilët draftin e përcjellin në Kuvend dhe e kanë të drejtën që ndryshimet që i konsiderojnë të nevojshme t'i përfshijnë në projektligj, pa miratim të grupit punues. Ai, po ashtu, bëri të ditur se sipas ndryshimeve në Zyrën e Kryeministrit, tani protokollin i shtetit kalon në kompetencë të Zyrës së Kryeministrit.

Vjosa Osmani- Sadriu, duke iu referuar nenit 89 të projektligjit, lidhur me protokollin e shtetit, tha se nuk është sqaruar se protokollin i diplomatik do të mbetet te Ministria e Punëve të Jashtme, kurse ai shtetëror do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Lidhur me rekomandimet e Komisionit për Grada, ku ministrit i është dhënë mundësia të refuzojë rekomandimin e këtij komisioni, pa asnjë arsye, pyeti: A është shqyrtuar mundësia që ministri të mos ketë një diskrecion të tillë për të vendosur?

Çerkin Dukolli, tha se nëse komisioni rekomandon për një person që të gradohet, atëherë nuk ka asnjë arsye që ministri mos ta miratojë atë. Ai, më tej, shtoi se nëse specifikisht është në diskrecion të ministrit, ndoshta është temë që mund të debatohet.

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se ka pasur raste kur Komisioni për Grada, ka dhënë rekomandime të qarta për disa diplomatë dhe ministri në atë kohë nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të vendosur, por mosnënshkrimi ka qenë një refuzim. Ideja është që të eliminohen mundësitë e tilla të shpërdorimit nga politikanët.

Jetish Jashari, tha se pikënisja për këtë çështje ka qenë ligji në fuqi, në të cilin kanë qenë dy dispozitat që ua mundësojnë diplomatëve për t'i ngritur në grada dhe një dispozitë është ngritja në detyrë. Kjo është marrë parasysh edhe kur është diskutuar për formulimin e këtij projektligji dhe është menduar që kjo t'i kufizohet ministrit. Ministri mund ta ngre në gradë dikë, vetëm nëse ka rekomandim nga Komisioni për Grada.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se nuk ka menduar që t'i jepet kompetenca e plotë Komisionit për Grada, por ministri duhet të ketë arsytim të fuqishëm se pse po e refuzon ta nënshkruajë një rekomandim të Komisionit për Grada. Ajo, më tej, njoftoi se në ligj nuk është përfshirë ndjeshmëria gjinore, përkundër kërkesës Kushtetuese, që Konventa për eliminimin e të gjitha diskriminimeve në raport me gratë, e cila parasheh që edhe në misione jashtë vendit duhet të parashihet çështja e barazisë gjinore, si dhe Ligji për barazi gjinore, në mënyrë specifike parasheh që jo vetëm për institucionet brenda, por edhe për përfaqësimin jashtë, duhet të parashihet kuota prej 40% për barazi gjinore. Kryetarja, po ashtu, njoftoi se në Projektligjin për diasporën është paraparë që të emërohen atashetë e diasporës, të cilët do të funksionojnë përbrenda ambasadave, me status të diplomatit dhe kjo çështje nuk mund të bëhet, nëse nuk rregullohet brenda ligjit aktual.

Jetish Jashari, njoftoi se ka marrë pjesë në draftimin e Projektligjit për diasporën dhe aty është shtruar çështja se çfarë statusi dhe çfarë komunikimi do ta kenë qendrat kulturore. Lidhur me këtë njoftoi se në Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm është paraparë edhe grada e atasheut, e cila i epët të deleguarit të ministrisë në ambasadën e caktuar. Në këtë projektligj është propozuar që ai atashe, pasi që do të jetë atashe kulturor, do ta ketë edhe rolin e udhëheqësit të qendrës kulturore e cila është nën ombrellën e ambasadës.

Elmi Reçica, tha se ai atashe, i cili drejton qendrën kulturore, duhet të jetë nga vendi ku e ka selinë qendra kulturore.

Jetish Jashari, tha se sa i përket zbatimit të ligjit për shërbimin e jashtëm dhe legjislacionit tonë ai mund të jetë edhe me nënshtetësi të dyfishtë, sepse kjo parashihet edhe në ligj, por ai person duhet ta ketë shtetësinë e Kosovës.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se nëse MDIS propozon një atashe me vendqëndrim në një shtet tjetër dhe në qoftë se në atë shtet nuk lejohet dyshtetësia, atëherë atij personi nuk mund t'i jepet grada e atasheut.

Jetish Jashari, njoftoi se sipas këtij projektligji, kushti për të qenë anëtar i shërbimit të jashtëm është shtetësia e Kosovës.

Çerkin Dukolli, lidhur me ndjeshmërinë gjinore, pyeti se a është fjala që të vendoset kuota gjinore në çdo ligj.

Vjosa Osmani- Sadriu, duke iu referuar zëvendësministrit Dukolli, tha se nuk e kishte fjalën që të vendoset në çdo ligj një kuotë, sepse Ligji për barazi gjinore përcakton rregulla për të gjitha institucionet, si për përfaqësimin brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Elmi Reçica, tha se është me rëndësi që Kuvendit i është përcjellë ky projektligj dhe në mandatin e kaluar, për shkak se nuk ka pasur precizim, ka përfunduar shpejt ai mandat, ndërsa ligji është kthyer mbrapa. Lidhur me projektligjin, tha se në tërë tekstin e projektligjit është e precizuar saktë çështja e diplomatëve të karrierës dhe atyre politikë, vetëm në një pjesë të tij jo dhe do të duhej të precizohet edhe aty. Ai, po ashtu, tha se projektligji e ka saktësuar procedurën për kthimin e diplomatëve në ministri, pasi që në të kaluarën ka pasur shumë vërejtje për këtë çështje. Do të duhej që me një rregullore të brendshme të përcaktohet qartë se nuk mund të ketë shpenzime të njëjta, sikurse në

Uashington ashtu edhe në Tiranë ose Shkup, pra duhet të bëhet një diferencim. Më tej, z. Reçica tha se duhet të rregullohet me një rregullore të brendshme çështja e shpenzimeve jashtë vendit. Sa i përket protokollit, tha se ai është shumë i shpërndarë dhe i shumanshëm. Shtetet që kanë vërtet protokoll e kanë vetëm një protokoll. Lidhur me këtë, bëri të ditur se është ithtar që të protokollit i shtetit të jetë për të gjithë dhe ai duhet të jetë i veçantë.

Vjosa Osmani- Sadriu, propozoi që Projektligji për Shërbimin e Jashtëm të shqyrtohet në parim, më datë 12 prill 2019, në mungesë të kuorumit për të votuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.